



Prishtinë, 31 mars 2016  
Kodi i ZRRE: V\_799\_2016

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,**

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 dhe 2.16, Nenet 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Rregullën për vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së);
- Vendimi i ZRRE-së nr. V\_517\_2013 për Të Hyrat Maksimale Të Lejuara (MAR) që do të mbulohen nga Operatori i licencuar i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH); dhe
- Aplikacionin e KEDS-OSSH-së të dorëzuar me 20 janar 2016 në kuadër të Shqyrtimit të Dhjetë të Tarifave të Energjisë Elektrike(SHTE10) me dokumentacionin relevant sqarues.

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur më 31 mars 2016 nxori këtë:

## VENDIM

- I. **APROVOHEN TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (MAR)** që do të mbulohen nga Operatori i licencuar i **Sistemit të Shpërndarjes (OSSH)** përmes ngarkesave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes për vitin relevant tarifor SHTE10.

## ARSYETIM

- ✚ Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka pranuar nga KEDS aplikacionin e OSSH-së për aprovim të Hyrave të Lejuara Maksimale, që duhet mbledhur nga OSSH-ja përmes ngarkesave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes( DUOS).
- ✚ Në marrjen e vendimit të tij për MAR, që do të mbulohet nga OSSH, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet si në vijim, që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen e saj:
  - Vlerësimi përfundimtar – Detajet mbi Operatorin e sistemit të shpërndarjes dhe të furnizuesit publik , i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
  - Vlerësimi i përfundimtar-Pasqyrë, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
  - Raport Konsultativ – Llogaritja e Kostos së Blerjes me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar më datën 24 Shkurt 2016;
  - Raport Konsultativ - Llogaritja e MAR-it të OSSH-së, i publikuar më datën 24 Shkurt 2016;




- Përgjigjet ndaj Komenteve - Shqyrtimi i dhjetë i tarifave të energjisë elektrike SHTE10, i publikuar me datën 31 mars 2016.
- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga OSSH-ja për vitin relevant tarifor SHTE10 janë **76,509,315** euro.
  - III. Të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSH të paraqitura në tabelë do t'i nënshtrohen Procesit të Përshtatjeve të Rregullta vjetore, sipas Rregullës për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes.
  - IV. Mbajtësi i licencës për OSSH duhet t'i përgatis dhe dorëzoj për aprovim ZRRE-së ngarkesat për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes (DUOS) të përcaktuar me MAR-in e këtij vendimi para vitit relevant tarifor.
  - V. Ngarkesat e propozuara nga OSSH duhet të jenë në përputhje me Metodologjinë e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes të aprovuar nga ZRRE.
  - VI. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të përkthimeve, do të mbisundojë versioni i gjuhës shqipe.
  - VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga operatori i Shpërndarjes duke filluar nga 1 prilli 2016 deri në shqyrtimin e rregullt tarifor, dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Enver Halimi, kryesues

  
Krenar Bujupi, anëtar,

  
Arsim Janova, anëtar,

  
Qemajl Mustafa anëtar,

  
Besim Sejfi anëtar.

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.